



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 qershor 2022
Nr. ref.: RK 2009/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI182/21

Parashtrues

Kamer Ukaj

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit Rev. nr. 568/2020 të 7 majit 2021, të Gjykatës Supreme të
Republikës së Kosovës**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Kamer Ukaj, me vendbanim në fshatin Radostë, komuna e Rahovecit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson Miftar Qelaj, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit Rev. nr. 568/2020, të 7 majit 2021, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).
3. Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 28 korrik 2021.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar [Rev. nr. 568/2020], me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Efektive] dhe 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenet 6.1 [E drejta për një proces të rregullt] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 11 tetor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 14 tetor 2021, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës KI182/21 dhe nga i njëjti kërkoi plotësimin e formularit të kërkesës, si dhe bashkëngjitjen e autorizimit të vlefshëm si dëshmi e përfaqësimit të tij në Gjykatë.
8. Më 18 tetor 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi, gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
9. Më 10 nëntor 2021, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të dorëzonte një autorizim të vlefshëm përkitazi me përfaqësimin e tij në Gjykatë.
10. Më 18 nëntor 2021, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një autorizim të vlefshëm që dëshmon se në procedurë para Gjykatës i njëjti përfaqësohet nga Miftar Qelaj.
11. Më 24 janar 2022, Gjykata një kopje të kërkesës ia dërgoi Gjykatës Supreme, aktgjykimi si së cilës është objekt i vlerësimit kushtetues në Gjykatë.
12. Më 23 mars 2022, Gjykata kërkoi fletëkthesën nga Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Rahovec, si dëshmi e dorëzimit të aktgjykimit të kontestuar të parashtruesi i kërkesës.

13. Më 23 maj 2022, Gjykata Themelore në Gjakovë-dega në Rahovec, dorëzoi në Gjykatë fletëkthesën e cila dëshmon se Aktgjykimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës, më 28 korrik 2021.
14. Më 8 qershor 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që të deklarojë kërkesën qartazi të pabazuar në baza kushtetuese dhe rrjedhimisht të papranueshme.

Përmbledhja e fakteve të rastit

Procedura administrative

15. Kuvendi Komunal i Rahovecit (në tekstin e mëtejme: KK Rahovec), kishte shpallur tenderin nr. 623-09-057-51, për rregullimin e rrjetit të ujësjellësit për disa fshatra të saj. Fituese e këtij tenderi ishte shpallur Operatorit Ekonomik NPN Xërxa & Gashi-ING. Pas kësaj faze ndaj parashtruesit të kërkesës, si menaxher i zyrës së prokurimit në KK Rahovec janë iniciuar procedurat e mëposhtme.
16. Më 27 dhe 28 tetor 2009, Organi Shqyrtues i Prokurimit (në tekstin e mëtejme: OSHP), kishte pranuar ankesa nga palët ankimore kundër njoftimit për dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik NPN. Xërxa & Gashi-ING në lidhje me tenderin nr. 623-09-057-51.
17. Më 10 nëntor 2009, Eksperti shqyrtues, i cili ishte caktuar nga OSHP, kishte dorëzuar një raport të ekspertizës, ku u konstatua se autoriteti kontraktues i KK Rahovec, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave ka bërë shkelje të Ligjit të Prokurimit Publik (në tekstin e mëtejme: LPP).
18. Më 17 nëntor 2009, Paneli Shqyrtues nxori Vendimin [nr. 2607/09], nëpërmjet të cilit kishte kërkuar nga KK Rahovec, që të bënte rivlerësimin e ofertave në lidhje me tenderin nr. 623-09-057-51.
19. Më 8 dhjetor 2009, OSHP, nëpërmjet Urdhëresës nr. 2927/09, kishte urdhëruar autoritetin kontraktues KK Rahovec, që të zbatonte vendimin e Panelit Shqyrtues [nr. 2607/09], të 17 nëntorit 2009.
20. Më 16 dhjetor 2009, OSHP njoftoi kryetarin e komunës së Rahovecit, se më 14 dhjetor 2009 OSHP mori Vendimin nr. 3039/09, nëpërmjet të cilit autoritetit kontraktues KK Rahovec dhe parashtruesit të kërkesës, u ishin caktuar masat ndëshkuese, si pasojë e mosrespektimit të Vendimit [nr. 2607/09] të Panelit Shqyrtues, të 17 nëntorit 2009. KK Rahovec u ndëshkua me: I. gjobë në lartësinë 5000,00 euro, ndërsa parashtruesi i kërkesës me: II. gjobë në lartësinë 1000.00 euro, dhe III. ndërprerje të marrëdhënies së punës, të cilit po ashtu iu ndalua puna si “nëpunës civil” dhe ushtrimi i pozitës në të gjitha autoritetet kontraktuese, në 3 (tri) vitet e ardhshme.
21. Më 8 janar 2010, parashtruesi i kërkesës, kundër Vendimit [nr. 3039/09] të OSHP-së, të 14 dhjetorit 2009, për caktimin e masës ndëshkuese parashtrroi ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil (në tekstin e mëtejme: KPMSHC), për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore, me propozimin që të anulohet Urdhëresa nr. 2927/09 e OSHP-së, e 8 dhjetorit 2009 dhe Vendimi [nr. 3039/09] i OSHP-së, i 16 dhjetorit 2009.
22. Më 12 janar 2010, KK Rahovec - Zyra e udhëheqësit të personelit, bazuar në Vendimin [nr. 3039/09] e OSHP-së, të 14 dhjetorit 2009 dhe Urdhëresën e kryetarit të KK Rahovec, të 12 janarit 2010, nxori Vendimin [nr. 18], nëpërmjet të cilit parashtruesi i kërkesës u njoftua për shpëputjen e marrëdhënies së punës.

23. Më 25 shkurt 2010, KPMSHC, nëpërmjet Vendimit A 02 (05) 2010: I. aprovoi ankesën e parashtruesit të kërkesës, dhe II. obligoi Komunën e Rahovecit që *ex officio* të zhvillojë procedurë disiplinore ndaj parashtruesit të kërkesës, para se t'i shkëputej marrëdhënia e punës.
24. Më 25 mars 2010, parashtruesi i kërkesës parashtroi një ankesë të dytë pranë KPMSHC-së, këtë herë kundër Vendimit [nr. 18] të KK Rahovec - Zyra e udhëheqësit të personelit, të 12 janarit 2010, për shkëputjen e marrëdhënies së punës.
25. Më 14 janar 2011, KPMSHC, me Vendimin nr. 02/48/2010, I. refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës të ushtruar më 25 mars 2010 dhe II. la në fuqi Vendimin e KK Rahovec, të 12 janarit 2010, i cili ishte nxjerrë në bazë të Vendimit të OSHP-së, të 14 dhjetorit 2009, me arsyetimin se KPMSHC ishte njoftuar nga u. d. udhëheqësi i personelit, i Komunës së Rahovecit, se nuk mund të zbatohet Vendimi [A 02 (05) 2010] i KPMSHC-së, për arsye se Urdhëresa [nr. 2927/09] e OSHP-së, e 8 dhjetorit 2009 dhe Vendimi [nr. 2607/09] i OSHP-së, i 17 nëntorit 2009, janë të formës së prerë, të cilat janë nxjerrë nga një organ më i lartë si KRPP dhe OSHP.

Procedura gjyqësore

26. Parashtruesi i kërkesës, pas vendimeve të KPMSHC-së, ushtroi padi në Gjykatën Supreme, me propozimin që vendimet e OSHP-së dhe të KK Rahovec, për shkëputjen e marrëdhënies së punës të anulohen, si të kundërligjshme.
27. Më 23 shkurt 2011, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktvendimit A. nr. 11/2010, shpalli veten jokompetente dhe lëndën ia delegoi Gjykatës Komunale në Rahovec, për të vendosur në procedurë të rregullt civile.
28. Gjykata Komunale në Rahovec, para se të mbante seancën e shqyrtimit kryesor, kishte kërkuar nga parashtruesi i kërkesës që të precizohet kërkesëpadija në aspektin subjektiv dhe objektiv të saj, për të kuptuar se kush janë palët e paditura dhe vendimet e goditura me kërkesëpadi.
29. Më 26 dhjetor 2012, Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Rahovec (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore), nëpërmjet Aktgjykimit C. nr. 75/2011, I. aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe anuloi Vendimin [nr. 3039/09] e OSHP-së, të 14 dhjetorit 2009 dhe Vendimin [nr. 18] e KK Rahovec, të 12 janarit 2010, për shkëputjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës, II. detyroi të paditurat që parashtruesit të kërkesës t'ia kompensojnë pagat e parealizuara, për periudhën kohore 12 janar 2010 deri në ditën e pensionimit, respektivisht deri më 25 maj 2018, në shumën e përgjithshme prej 47.118,10 euro, si dhe III. shpenzimet e procedurës gjyqësore në shumën prej 1.969,00 euro.
30. Brenda afateve ligjore, OSHP, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, të 26 dhjetorit 2012, për shkak të shkeljes së dispozitave të ligjit procedural dhe material dhe të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.
31. Më 22 nëntor 2016, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit Ac. nr. 1159/13, I. aprovoi ankesën e OSHP-së, dhe II. prishi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, të 26 dhjetorit 2012, duke e kthyer lëndën në rivendosje pranë kësaj të fundit, për t'i evituar mangësitë ligjore.

32. Deri më 3 korrik 2018, parashtruesi i kërkesës, me kërkesë të Gjykatës Themelore, e kishte precizuar kërkesëpadinë e tij disa herë.
33. Më 3 korrik 2018, Gjykata Themelore, duke vendosur në riprocedurë, nxori Aktgjykimin C.nr.422/2018, nëpërmjet të cilit: I. aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, dhe II. anuloi Vendimin [nr. 3039/09] e OSHP-së, të 14 dhjetorit 2009 dhe Vendimin [nr. 18] e KK Rahovec, të 12 janarit 2010, duke arsyetuar se sipas vlerësimit të ekspertit të OSHP-së, janë respektuar vendimet dhe rekomandimet e OSHP-së dhe se menaxheri i prokurimit publik i autoritetit kontraktues nuk kishte bërë asnjë shkelje të procedurës, e as shkelje të tenderimit dhe të detyrave të punës, por edhe sikur të kishte bërë ndonjë shkelje është dashur që ndaj tij të zhvillohej procedurë disiplinore për vërtetimin e përgjegjësisë, të përcaktuar me dispozitat e nenit 32 të Urdhërësës Administrative nr. 2003/02 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIKU-t, nr. 2001/36.
34. OShP, në afat ligjor, parashtroi ankesë në Gjykatën e Apelit, kundër Aktgjykimit [C.nr.422/2018] të Gjykatës Themelore, të 3 korrikut 2018, për shkak të shkeljes së dispozitave të ligjit procedural dhe material dhe të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike.
35. Më 26 maj 2020, Gjykata e Apelit, nëpërmjet Aktgjykimit Ac. nr. 3560/2018, I. refuzoi ankesën e ushtruar nga OShP, dhe II. konfirmoi si të drejtë dhe të ligjshëm Aktgjykimin [C.nr. 422/2018] e Gjykatës Themelore të 3 korrikut 2018.
36. OShP dhe KK Rahovec, të pakënaqura me Aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës së Apelit, parashtruan kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, për shkak të shkeljes së dispozitave të ligjit procedural dhe material, me propozimin që aktgjykimet e instancave më të ulëta të ndryshohen dhe kërkesëpadia e parashtruesit të kërkesës të refuzohet në tërësi, si e pabazuar.
37. Përgjigje në kërkesën për revizion në Gjykatën Supreme, kishte dorëzuar edhe parashtruesi i kërkesës, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar konfirmimin e aktgjytimeve të instancave me të ulëta, dhe refuzimin e kërkesës për revizion, si të pabazuar.
38. Më 7 maj 2020, Gjykata Supreme, nëpërmjet Aktgjykimit të kontestuar [Rev. nr. 568/2020], i. aprovoi revizionin e ushtruar nga OShP dhe KK Rahovec; ii. ndryshoi aktgjykimet instancave më të ulëta; iii. refuzoi në tërësi padinë e parashtruesit të kërkesës me të cilën kishte kërkuar anulimin e vendimit të OSHP-së, të 14 dhjetorit 2009 dhe të KK Rahovec, të 12 janarit 2010; dhe vi. refuzoi po ashtu kërkesën për kompensimin e pagave të paralizuara, në shumën e përgjithshme prej 47.118,10 euro.
39. Gjykata Supreme, nëpërmjet këtij aktgjykimi të lartcekur, konkludoi: *"... duke marrë parasysh këto rrethana, vendimet e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit nr. 3039/09 i datës 14.12.2009, si dhe aktvendimi i Komunës së Rahovecit, Zyra e Udhëheqësit të personelit në Administratën komunale nr.18, të datës 12 janar 2010, janë vendime të bazuara dhe të nxjerra konform dispozitave ligjore të nenit 118.2 të Ligjit nr. 02/L-99 të prokurimit publik, të cilat vendime si të ligjshme i ka konfirmuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendimin 02/48/2010, të datës 14.01.2011, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e paditësit e paraqitur kundër këtyre vendimeve".*

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

40. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të

Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Efektive] dhe 54 [Mbrotjtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës dhe nenet 6.1 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-së.

i. përkitazi me të drejtën për “gjykim të drejtë”

41. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme, nuk i përmbush standardet e një gjykimi të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, thekson se fakti që dy instanca gjyqësore aprovuan kërkesëpadinë e tij dhe vërtetuan se ai ka vepruar në harmoni me vlerësimin e ekspertit të OSHP-së dhe se i njëjti nuk ka bërë shkelje të ligjit, tregon që aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme është në kundërshtim me standardet kushtetuese të të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

a) përkitazi me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor

42. Parashtruesi i kërkesës, çështjen e mosarsyetimit të vendimit gjyqësor e ndërlidhë me konstatimin e Gjykatës Supreme, si në vijim: *“Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës nuk e pranon si të bazuar qëndrimin juridik, të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë lidhur me aprovimin e kërkesëpadisë së paditësit, pasi që aktgjykimet e shkallës së parë dhe të dytë, përfshihen me zbatim të gabuar të së drejtës materiale të nenit 32, paragrafi 1, të urdhëresës administrative 2003/02, mbi zbatimin e Rregullores së UNMIKU-t, nr. 2001/36, si dhe nenit 118.2 të Ligjit të prokurimit publik nr.02/L-99. Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës argumenton se, Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsye lidhur me faktet vendimtare edhe pse ka konstatuar se, e pranon gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë dhe dytë, të cilat konstatuan se nuk ka ekzistuar shkelje për të cilën i është shqiptuar masa ndëshkuese, largim nga puna. Në këtë kuptim, parashtruesi i kërkesës, thekson se mungesa e arsyetimit dhe e vërtetimit të fakteve, e bëjnë gjykimin të mos jetë i drejtë, andaj kjo çështje sipas tij duhet parë në dritën e praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 të Kushtetutës, i interpreton të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.*
43. Parashtruesi po ashtu pretendon se autoritetet publike nuk i kanë dhënë epilog shqyrtimit të pretendimeve të tij, duke vepruar kështu në mënyrë arbitrare, sepse në asnjë instancë gjyqësore nuk është shqyrtuar ligjshmëria e vendimit nr. 3039/09 të Organit Shqyrtues të Prokurimit, gjersa Gjykata Supreme, *“... ka gjetur se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, por në raport me gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën materiale”.*

b) përkitazi me vërtetimin e fakteve dhe aplikimin e ligjit

44. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se ajo që ka vërtetuar si gjendje faktike gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë është fakti se ato kanë vërtetuar faktin relevant se komisionet e autoritetit kontraktues të Komunës së Rahovecit, kanë vepruar në harmoni me vlerësimin e ekspertit të OSHP-së, kanë respektuar vendimet dhe rekomandimet e OSHP-së dhe se menaxheri i zyrës së prokurimit publik, i autoritetit kontraktues KK Rahovec, përkatësisht parashtruesi i kërkesës, nuk ka bërë asnjë shkelje të procedurës dhe as të detyrave të punës. Parashtruesi i kërkesës tutje thekson se parashtrimi i këtyre fakteve, në rastin konkret, bëhet me qëllim që të vërtetohet se ndaj kërkesës së tij, Gjykata Supreme nuk ka vepruar në pajtim me rolin kushtetues, përkatësisht me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], që përcakton: 3. *“Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.* Në këtë kontekst, ai argumenton se në frymën e kësaj dispozite kushtetuese është edhe detyrimi i gjykatës i

përcaktuar në dispozitën e Ligjit për Procedurën Kontestimore, përkatësisht me nenin 7.2, përcaktohet se: “Gjykata është e autorizuar t’i vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe t’i marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Nenin 7.3, Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.

ii. përkitazi me pretendimet tjera të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj.

45. Parashtruesi i kërkesës, si përmbledhje thekson se: “... nuk i është ofruar mundësi t’i kundërshtojë veprimet e autoriteteve me rastin e kufizimit të së drejtës së tij për punë dhe ushtrim i profesionit, sepse Gjykata Supreme nuk është lëshuar në vlerësimin meritator të kësaj çështje dhe në këtë mënyrë parashtruesi është privuar nga e drejta për gjykim të drejtë dhe për mjet efikas juridik, me çka është privuar edhe nga e drejta për mbrojtje gjyqësore, të drejta të garantuara me Kushtetutë, në dispozitat e përshkruara më lart”.
46. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata të deklarojë kërkesën të pranueshme dhe të konstatojë se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme i 7 majit 2021 është përfshirë me shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike], dhe nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës.

Dispozitat relevante

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshem, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 32

[E Drejta për Mjete Juridike]

Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj.

Neni 54

[Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]

Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 (E drejta për një proces të rregullt)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtonte interesat e drejtësisë.

[...]

Neni 13 (E drejta për zgjidhje efektive)

Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

KREU I [DISPOZITAT E PËRGJITHSHME]

Neni 7

7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

7.2 Gjykata është e autorizuar t'i vërtetojë edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur si dhe t'i marr edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar në nenin 3, paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

7.3 Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në faktet dhe provat lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.

MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES [REVIZIONI]

Neni 214

214.1 Revizioni mund të paraqitet:

- a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 188 i këtij ligji e cila është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë;*
- b) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale;*

c) për shkak të tejkalimit të kërkesëpadisë, po që se kjo parregullsi është bërë në procedurën e zhvilluar në gjykatën e shkallës së dytë.

214.2 Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.

214.3 Kundër aktgjykimit të dhënë në procedurën e shkallës së dytë, me të cilin vërtetohet aktgjykimi në bazë të pohimit, revizioni mund të paraqitet vetëm nga shkaqet e përmendura në paragrafin 1 pika a) dhe b) dhe paragrafin 2 të këtij neni.

214.4 Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë me të cilin vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë, revizioni nuk lejohet për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore nga paragrafi 1 pika a) e këtij neni, po që se ekzistimi i tyre nuk është përmendur fare në ankesë, përveç se kur është fjala për shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare vet gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e revizionit.

Neni 215

Gjykata e revizionit e shqyrton aktgjykimin e goditur vetëm në pjesën e tij të goditur me anë të revizionit dhe vetëm brenda kufijve të shkaqeve të treguara në revizion, por duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e drejtë të së drejtës materiale dhe për shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore që kanë të bëjnë me zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt.

Neni 216

Palët mund të parashtrojnë me revizion fakte të reja dhe të propozojnë prova të reja vetëm nëse ato kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të procedurës kontestimore të bëra në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë.

Pranueshmëria e kërkesës

47. Gjykata së pari shqyrton nëse janë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

48. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

[...]

49. Gjykata gjithashtu më tej i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç specifikohen më tej në Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet neneve 47 (Kërkesa individuale), 48 (Saktësimi i kërkesës) dhe 49 (Afatet) të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47

[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor[...]”.

50. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kritereve, Gjykata fillimisht thekson se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, e cila konteston një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 568/2020, të 7 majit 2021, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu i ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.
51. Megjithatë, përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], përkatësisht nënregullin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.

52. Bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkthazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t’iu referohet të njëjtave, si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kategorizohen si pretendime “të shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”, atëherë kur plotësohet njëri nga dy nënkriteret, në vijim: a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit qartazi duket shkelja e Kushtetutës dhe KEDNj-së (shih, rastin e GjEDNj-së *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, vendimi i 31 majit 2005; shih gjithashtu *Baillard kundër Francës*, nr. 6032/04, vendimi i 25 shtatorit 2008); dhe b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë prova materiale, me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë atë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t’ia paraqesë Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih, rastin e Gjykatës KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, i 5 janarit 2021, paragrafi 43), dhe në fund, (iv) pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, rastet e GjEDNj-së, *Kemmachev kundër Francës*, nr. 17621/91,

kategoria (i), *Mentzen kundër Lituanisë*, nr. 71074/01, kategoria (ii) dhe *Trofimchuk kundër Ukrainës*, nr. 4241/03, kategoria (iii)).

53. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme shkel të drejtat e tij të garantuara me nenet 31, 32 dhe 54 të Kushtetutës, me nenet 6.1 dhe 13 të KEDNj-së.
54. Bazuar në shkresat e lëndës, Gjykata vëren se thelbi i kërkesës së parashtuesit të kërkesës ngrenë pretendime të procesit të rregullt gjyqësor, gjegjësisht të së drejtës për një gjykim të drejtë, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së.
55. Andaj, në vlerësimin e pretendimeve të shkeljes së të drejtës për “gjykim të drejtë”, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë.

i. Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me të drejtën për “gjykim të drejtë”

56. Gjykata, fillimisht, rikujton përmbajtjen e dispozitave të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj”.

[...]

57. Përveç kësaj, Gjykata rikujton gjithashtu përmbajtjen e paragrafit 1, të nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNj-së, që përcakton:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë ... edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij”.

[...]

58. Gjykata fillimisht rikujton se pretendimet për shkeljen e të së drejtës për gjykim të drejtë, ndërlidhen me dy çështje, e para me mënyrën e vërtetimit të fakteve dhe zbatimin e të së drejtës materiale, dhe e dyta me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor.

a) Përkitazi me vërtetimin e fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit

59. Gjykata rikujton se parashtuesi i kërkesës pretendimin për shkelje të së drejtës për “gjykim të drejtë” përveç tjerash, e mbështet në faktin se Gjykata Supreme nuk e ka marrë parasysh çështjen e vërtetimit të fakteve nga gjykatat e instancës më të ulët, kur ato në bazë të ekspertizës financiare kanë vërtetuar faktin relevant se komisionet e autoritetit kontraktues të Komunës së Rahovecit, kanë vepruar në harmoni me vlerësimin e ekspertit të OSHP-së, kanë respektuar vendimet dhe rekomandimet e OSHP-së dhe se menaxheri i zyrës së prokurimit publik, i autoritetit kontraktues i komunës së Rahovecit, përkatësisht parashtuesi i kërkesës, nuk ka bërë asnjë shkelje të procedurës dhe as të detyrave të punës.

60. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka zbatuar gabimisht dispozitat e të drejtës procedurale, duke shtuar se është detyrimi i gjykatës i përcaktuar në dispozitën e Ligjit për Procedurën Kontestimore, përkatësisht me nenin 7.2 ku parashihet se Gjykata është e autorizuar t'i vërtetojë edhe faktet të cilat nuk i kanë paraqitur, si dhe t'i marrë edhe provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim deponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3, paragrafi 3 të këtij ligji), në qoftë se me ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Neni 7.3, parasheh që Gjykata nuk mund ta bazojë vendimin e vet në fakte dhe prova, lidhur me të cilat palëve nuk u është dhënë mundësia që të deklarohen.
61. Referuar pretendimeve të lartcekura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës, në këtë pjesë e ka ndërtuar kërkesën e tij në baza ligjshmërie dhe jo në baza kushtetutshmërie, duke pretenduar se Gjykata Supreme në mënyrë të gabuar ka aplikuar të drejtën procedurale, kur konstatoi se kërkesëpadia e tij duhej refuzuar si e pabazuar, për shkak se në rastin e tij aplikimi i të drejtës materiale ishte bërë në mënyrë të gabuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë (shih, në këtë kontekst, Gjykata Kushtetuese, rasti KI76/21, me parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 33).
62. Gjykata rikujton se bazuar në praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, e cila ndërlidhet me doktrinën e shkallës së katërt, vazhdimisht ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose të interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga gjykatat e rregullta, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe me KEDNj (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës KI179/18, parashtrues *Belgjyzar Latifi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 23 korrikut 2020, paragrafi 68; KI49/19, parashtrues *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A., “Adem Jashari”*, Aktvendim i 31 tetorit 2019, paragrafi 47; KI56/17, me parashtruese *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 35; dhe KI154/17 dhe KI05/18, me parashtrues, *Basri Deva, Afërdita Deva dhe Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “Barbas”*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 gushtit 2019, paragrafi 60, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtruesi *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 34).
63. Gjykata vazhdimisht ka pohuar se nuk është roli i saj të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GjEDNj-së *García Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdoruar aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës, KI49/19, cituar më lart, paragrafi 48; dhe KI154/17 dhe KI05/18, cituar më lart, paragrafi 61, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtruesi *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 35).
64. Gjykata, megjithatë, thekson se praktika gjyqësore e GjEDNj-së dhe e Gjykatës gjithashtu përcaktojnë rrethana nën të cilat duhet të bëhen përjashtime nga ky qëndrim. Siç u theksua më lart, përderisa gjykatat e rregullta kanë detyrë primare të zgjidhin problemet rreth interpretimit të ligjit të aplikueshëm, roli i Gjykatës është që të sigurohet apo të verifikojë që efektet e këtij interpretimi të jenë kompatible me Kushtetutën dhe KEDNj-në (shih, për me shumë GjEDNj, rastin *Miragall Escolano dhe të tjerët kundër Spanjës*, aplikimet nr. 38366/97, 38688/97, 40777/98, 40843/98,

41015/98, 41400/98, 41446/98, 41484/98, 41487/98 dhe 41509/98, Aktgjykim i 25 janarit 2000, paragrafët 33-39; dhe shih, gjithashtu rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafi 63). Në parim, një përjashtim i tillë, ndërlidhet me raste të cilat rezultojnë të jenë dukshëm arbitrare, duke përfshirë ato në të cilat, një gjykatë ka “aplikuar ligjin në mënyrë qartazi të gabuar” në një rast specifik dhe i cili mund të ketë rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin përkatës (për një sqarim më të detajuar përkitazi me konceptin e “aplikimit të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar”, shih, ndër të tjera, Udhëzuesin e GjEDNj-së për nenin 6 të KEDNj-së (aspekti civil), të 31 gushtit 2020, pjesën IV. Kriteret Procedurale; 3. Shkalla e Katërt; b. Fushëveprimi dhe Kufizimet e mbikëqyrjes së Gjykatës, paragrafët 329-333; dhe rastin e Gjykatës KI154/17 dhe KIO5/18, cituar më lart, paragrafët 60 deri në 65 dhe referencat e përdorura aty, dhe së fundmi rasti KI76/21, parashtrues *Qemajl Babuni*, Aktvendimi i 10 nëntorit 2021, paragrafi 36).

65. Duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës dhe shkresat e lëndës, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka arritur të dëshmojë se efektet e interpretimit dhe të zbatimit të së drejtës materiale dhe procedurale nuk janë kompatible me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj. Për më tepër, nga arsyetimi i Aktgjykimit të kontestuar vërehet qartë se në rrethanat e rastit konkret, nuk kemi të bëjmë as me “*aplikim të ligjit në mënyrë qartazi të gabuar*” dhe as me “*konkluzione arbitrare*” apo “*qartazi të paarsyeshme*”.
66. Andaj, nga sa më lart, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, bien në kategorinë e parë (i) të pretendimeve të “*shkallës së katërt*” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel ligjshmërie dhe nuk janë argumentuar në nivel kushtetutshmërie, andaj, si të tilla, duhet të shpallen qartazi të pabazuara, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

b) Vlerësimi i Gjykatës përkitazi me “mosarsyetimin e vendimit gjyqësor”

a) Parimet e përgjithshme

67. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNj-së (përfshirë, por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, nr. 12945/87 Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, nr. 49684/99, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801/97, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, nr. 61302/00, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, nr. 63566/00, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, nr. 1509/02, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007.) Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate (duke përfshirë, por duke mos u kufizuar në KI22/16, parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim, i 13 qershorit 2018; KI87/18, parashtrues i kërkesës *IF Skadiforsikring*, Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, dhe KI24/17, parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019, KI35/18, parashtrues *Bayerische Versicherungsverband*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 135).

68. Në parim, Gjykata thekson se garancitë e mishëruara në nenin 6.1 të KEDNj-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih, rastin e GJEDNj-së, *H. kundër Belgjikës*, nr. 8950/80, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53; si dhe shih rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, të cituar më lart, paragrafi 139 dhe rastin KI87/18, parashtrues *IF Skadiforsikring*, paragrafi 44).
69. Gjykata po ashtu thekson se bazuar në praktikën e saj gjyqësore gjatë vlerësimit të parimit i cili i referohet administrimit të duhur të drejtësisë, vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë arsyetimin në të cilat ato bazohen. Shkalla në të cilën zbatohet detyrimi për të dhënë arsye mund të ndryshojë varësisht nga natyra e vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të rastit konkret. Janë argumentet thelbësore të parashtruesit të kërkesës që duhet të adresohen, dhe arsyet e dhëna duhet të jenë të bazuara në ligjin e aplikueshëm (shih, në mënyrë të ngjashme rastet e GJEDNj-së *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, nr. 18064/91 Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 27; dhe *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, nr. 134/1996/753/952. Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998, paragrafi 42, shih, po ashtu, rastin e Gjykatës KI97/16, parashtrues *IKK Classic*, të cituar më lart, paragrafi 48; dhe rastin KI87/18 *IF Skadeforsikring*, të cituar më lart, paragrafi 48). Duke mos kërkuar një përgjigje të detajuar për secilën ankesë të ngritur nga parashtruesi i kërkesës, ky obligim nënkupton që palët në procedurë gjyqësore mund të presin që të pranojnë një përgjigje specifike dhe eksplicite ndaj pretendimeve të tyre që janë vendimtare për rezultatin e procedurës së zhvilluar (shih, rastin *Morerira Ferreira kundër Portugalisë*, nr. 19867/12, Aktgjykim i 11 korrikut 2017, paragrafi 84 dhe të gjitha referencat e përmendura aty; si dhe rastin e Gjykatës KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 137).
70. Përveç kësaj, Gjykata i referohet edhe praktikës së saj gjyqësore ku ajo përcakton se arsyetimi i vendimit duhet të theksojë raportin ndërmjet konstatimeve të meritës dhe shqyrtimit të provave nga njëra anë, dhe konkluzionet ligjore të gjykatës, nga ana tjetër. Aktgjykimi i gjykatës do të shkelë parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre (shih, rastet e Gjykatës nr. KI72/12, *Veton Berisha dhe Ilfete Haziri*, Aktgjykimi i 17 dhjetorit 2012, paragrafi 61; KI135/14, *IKK Classic*, Aktgjykimi i 9 shkurtit 2016, paragrafi 58, dhe KI96/16 *IKK Classic*, Aktgjykimi i 8 dhjetorit 2017; KI87/18 parashtrues "*IF Skadeforsikring*", Aktgjykim i 27 shkurtit 2019, paragrafi 44; KI138/19 parashtrues *Ibish Raci*, cituar më lart, paragrafi 45; si dhe KI230/19, parashtrues *Albert Rakipi*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 2020, paragrafi 138).
71. Në këtë drejtim, Gjykata do të shtjellojë nëse pretendimet e parashtruesit të kërkesës për mungesë të një vendimi të arsyetuar gjyqësor janë në përputhshmëri me garancitë procedurale të mishëruara në nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.
- b) Zbatimi i parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret
72. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës përkitazi me këtë pretendim thekson se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsye lidhur me të gjitha faktet vendimtare edhe përkundër faktit se e ka pranuar gjendjen faktike të konstatuar nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë, të cilat konstatuan se nuk ka ekzistuar shkelje për të cilin i është shqiptuar masa ndëshkuese, largim nga puna ndaj tij. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se autoritetet publike nuk i kanë dhënë epilog shqyrtimit të pretendimeve të tij, duke vepruar kështu në mënyrë arbitrarë, sepse në asnjë instancë gjyqësore nuk është shqyrtuar ligjshmëria e Vendimit nr. 3039/09 të OSHP-së, gjersa Gjykata Supreme, "... ka gjetur se gjykata e shkallës së parë në mënyrë

të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, por në raport me gjendjen faktike të vërtetuar, në mënyrë ta gabuar ka aplikuar të drejtën materiale”.

73. Në vazhdim, Gjykata vëren se sa i përket pretendimit se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare, i referohet pjesëve relevante të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, e cila në këtë kontekst arsyetoi: *“Gjykata Supreme nga shkresat e lëndës, provat e administruara ka gjetur se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, por në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar e ka aplikuar të drejtën materiale duke aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe duke i anuluar si të kundërligjshme vendimet e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit nr.3039/09, të datës 14.12.2009, si dhe aktvendimin e Komunës së Rahovecit, Zyra e Udhëheqësit të personelit në Administratë Komunale nr.18, të datës 12.01.2010 dhe se arsyet e dhëna nga gjykata e shkallës së parë dhe e dytë janë të paqëndrueshme dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 118.2 të Ligjit nr.02/L-99 të prokurimit publik, i cili ka qenë në fuqi në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së paditësit”.*
74. Në sa u tha më lart, Gjykata vëren se është e vërtetë se Gjykata Supreme nuk e ka kontestuar gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë, por ajo, në rrethanat e rastit konkret, thjesht nuk është pajtuar me gjetjet e atyre gjykatave, sa i përket ligjit material të aplikueshëm. Gjykata edhe njëherë përsërit qëndrimin e saj se një vendim i gjykatës së rregullt do të shkelte parimin kushtetues të ndalimit të arbitraritetit në vendimmarrje, në qoftë se arsyetimi i dhënë nuk i përmban faktet e vërtetuara, dispozitat ligjore dhe marrëdhënien logjike midis tyre. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme ka arsyetuar se nuk ka ekzistuar një marrëdhënie logjike juridike, ndërmjet fakteve të vërtetuara dhe ligjit material të aplikueshëm, duke argumentuar se në rrethanat e rastit të parashtruesit të kërkesës, ligji i aplikueshëm ishte Ligji për Prokurimin Publik dhe jo Urdhëresa Administrative 2003/02 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr. 2001/36.
75. Gjykata Supreme, sa i përket konkluzioneve në lidhje aplikimin e ligjit material të aplikueshëm, në Aktgjykimin e saj, arsyetoi: *“Me dispozitën e nenit 118.2 të Ligjit nr.02/L-99 të prokurimit publik, është paraprë se “Nëpunësi civil, punonjësi ose zyrtari i autoritetit kontraktues që dështon në respektimin e urdhërit do të pushohet nga puna dhe do të gjohet me një shumë që nuk është më e vogël se 1.000 euro. Personi i tillë nuk mund të bëhet prapë nëpunës civil, punonjës ose zyrtar i një autoriteti kontraktues për një periudhë trevjeçare pas pushimit nga puna”, bazuar në këtë dispozitë, përjashtohet mundësia që në rastin e zbatimit të kësaj dispozite të zhvillohet procedurë disiplinore e paraprë për shërbyesin civil sipas Urdhëresës administrative 2003/02 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut, nr.2001/36 pasi kushti i vetëm është që nëpunësi civil të dështoj në respektimin e urdhërit siç është në rastin konkret me paditësin i cili ka dështuar që të respektojë urdhrin e dhënë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, i cili në vendimin nr.2778/09 të datës 17.11.2009, në pikën VI. ka dhënë udhëzimet se mosrespektimi i këtij vendimi detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 118 të LPP-së të ndërmarrë të gjitha masat ndaj të gjithë nëpunësve të paraparë me këtë ligj”.*
76. Tutje në lidhje me këtë pjesë, Gjykata Supreme, arsyetoi: *“Paditësi me shkresën e tij të datës 12.11.2009 është pajtuar se gjatë procedurave të prokurimit të tenderit mbi ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit për fshatin Dobidol, Çifllak, Pllushë, Petkoviç dhe Kramovik me numrin e prokurimit 623-09057-511 i cili është shpallur me datën 10.09.2009 ka pasur mangësi në zbatimin e dispozitave ligjore dhe ka pranuar të gjeturat e konstatuara si në aktin përcjellës nr.2730/09 të datës 10.11.2009 por përkundër kësaj në procedurat e rivlerësimit ka dështuar që t'i eliminojë shkeljet dhe të veprojë sipas urdhrit të dhënë në vendimin nr.2607/09, të datës 17.11.2009 nga*

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pasi bazuar në të gjeturat si në aktin përcjellës nr.3005/09, të datës 15.12.2009 është konstatuar se nuk janë eliminuar shkeljet e urdhëruara sipas këtij vendimi. Po ashtu, bazuar në urdhëresën nr. 2927/09 të datës 08.12.2009 të nxjerrë nga organi Shqyrtues i Prokurimit është urdhëruar Autoriteti Kontraktues pranë KK Rahovec, që në afat prej tri (3) ditëve të zbatojë vendimin e Panelit Shqyrtues nr. 2607/09 të datës 17.11.2009, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për fshatin Dobidol, Çifllak, Pllushë, Petkoviq dhe Kramovik me numrin e prokurimit 623-09057-511, duke tërhequr vërejtjen se mosrespektimi i vendimit të datës 17.11.2009, e detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 118 të LPP-së, ndaj autoritetit kontraktues të vendosë një gjobë prej jo më pak se 5000,00 euro ndërsa nëpunësi civil (zyrtari i prokurimit) që dështon në respektimin vendimit do të pushohet nga puna dhe do të gjobitet me një shumë që nuk është më e vogël se 1000,00 euro, si dhe nuk mund të bëhet prapë nëpunës civil ose zyrtar i një autoriteti kontraktues për një periudhë trevjeçare pas pushimit nga puna. Dhe përkundër kësaj urdhërese nga të gjeturat në aktin përcjellës nr.3005/09 15.12.2009 është konstatuar se nuk janë eliminuar shkeljet e urdhëruara si në vendimin e Panelit Shqyrtues Nr.2607/09 të datës 17.11.2009. Andaj, duke marrë parasysh këto rrethana, vendimet e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit nr.3039/09 i datës 14.12.2009, si dhe aktvendimi i Komunës së Rahovecit, Zyra e Udhëheqësit të personelit në Administratën komunale nr.18, të datës 12 janar 2010, janë vendime të bazuara dhe të nxjerrra konform dispozitave ligjore të nenit 118.2 të Ligjit nr.02/L-99 të prokurimit publik, të cilat vendime si të ligjshme i ka konfirmuar edhe Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me vendimin 02/48/2010, të datës 14.01.2011, me të cilin vendim është refuzuar ankesa e paditësit e paraqitur kundër këtyre vendimeve”.

77. Ndërsa sa i përket pretendimit se ekspertiza financiare e ekspertit nuk e kishte nxjerrë atë përgjegjësi për shkelje të detyrave të punës, duke theksuar se në rastin konkret nuk ka ekzistuar shkelje për të cilën parashtruesit të kërkesës i është shqiptuar masa ndëshkuese, largim nga puna ndaj tij, Gjykata Supreme arsyetoi: “Gjykata Supreme, vlerëson se nxjerrja dhe administrimi i provave i ekspertizave ekonomiko-financiare të ekspertëve B.I, J.T dhe V.I ka qenë plotësisht i panevojshëm, dhe si të tilla nuk kanë ndonjë vlerë provuese, pasi që dispozitat ligjore neni 118, të Ligjit nr.02/L-99 të Prokurimit publik, kanë përcaktuar në mënyrë decitive se mosveprimi sipas urdhrave të organit më të lartë ka pasojat e caktuara për organin vartës dhe se këtë diskrecion për të vlerësuar si organ mbikëqyrës ligji i ka dhënë Organit Shqyrtues të Prokurimit ...”. Duke shtuar tutje se “Përjashtim kur organi mund të mos zbatojë urdhrat e dhëna nga organi më i lartë është në situatën kur zbatimi i urdhrat do të përbënte elementet e veprës penale por që në këtë rast konkret paditësi nuk ka mundur të vërtetojë këtë rrethanë dhe as që ka pasur pretendime në këtë drejtim”.
78. Gjykata vëren se si përfundim, Gjykata Supreme konstatoi: “Për këto arsye Gjykata Supreme vlerëson se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë gabimisht kanë zbatuar këtë dispozitë ligjore. Nenin 32 paragrafi 1, të Urdhëresës administrative 2003/02 mbi zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36, si dhe nenin 118.2 të Ligjit të prokurimit publik nr.02/L-99, kur kanë gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, për të cilën arsye u deshtë që të dy aktgjykimet e lartpërmendura të ndryshohen dhe kërkesëpadia e paditësit të refuzohet si e pabazuar në tërësi, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi”.
79. Nga sa më sipër, Gjykata konsideron se Gjykata Supreme në mënyrë specifike i është përgjigjur të gjitha pretendimeve të dorëzuara nga parashtruesi i kërkesës, si përgjigje ndaj revizionit të ushtruar nga të paditurat OSHP dhe KK Rahovec, duke dhënë arsye të detajuara se përse është dashur që aktgjykimet e instancave më të ulëta, të ndryshohen dhe kërkesëpadia e tij të refuzohet si e pabazuar. Në këtë kontekst, Gjykata

konsideron se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se arsyetimi i dhënë në Aktgjykimin e kontestuar nga ana e Gjykatës Supreme nuk përkon me standardet e mirëarsyetimit të një vendimi gjyqësor është i pa mbështetur me argumente bindëse.

80. Gjykata dëshiron të rikujtojë gjithashtu, se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6.1 i KEDNj-së, i obligojnë gjykatat që të arsyetojnë vendimet e tyre, megjithatë, kjo nuk mund të interpretohet në mënyrë të tillë që nga ato të kërkohej përgjigje e hollësishme për secilin pretendim (shih, rastet e GjEDNj-së, *Van de Hurk kundër Holandës*, nr. 16034/90, Aktgjykimi i 19 prillit 1994; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, Aktgjykimi i 21 janarit 1999, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, [DHM], nr. 40490/98, Vendimi i 29 gushtit 2000, paragrafi 81).
81. Për sa më sipër, në vlerësimin e pretendimeve që ndërliken me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, Gjykata e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmimeve të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, ndër të tjera, rastin e GjEDNj-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtrues i kërkesës *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
82. Gjykata konsideron se në rastin e parashtruesit të kërkesës janë respektuar të gjitha kriteret e lartcekura nga ana e Gjykatës Supreme, vendimtarja e së cilës është në pajtueshmëri me standardet e kërkuara me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së. Parashtruesi i kërkesës edhe më tej mund të mos jetë i kënaqur me rezultatin e gjykimin të çështjes së tij, megjithatë, pakënaqësia e tij nuk mund vetvetiu të ngrejë një pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë (shih, rastin e GjEDNj-së *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
83. Në këtë kontekst, Gjykata rikujton se dispozitat e nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6.1 të KEDNj-së, nuk i garantojnë askujt rezultat të favorshëm në proces gjyqësor dhe të njëjtat dispozita as nuk përcaktojnë që Gjykata ta vë në diskutim zbatimin e të drejtës materiale nga gjykatat e rregullta të një kontesti civil, ku kryesisht njëra prej palëve fiton dhe tjetra humb. (Shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI118/17 parashtrues *Şani Kervan dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 janarit 2018, paragrafi 36; KI49/19, cituar më lart, paragrafi 54; dhe KI99/19, parashtruese *Persa Raičević*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 dhjetorit 2019, paragrafi 48, dhe së fundmi rastin KI68/21, parashtrues *Leonard Matoshi*, Aktvendimi i 8 shtatorit 2021, paragrafi 51).
84. Andaj, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkelje të së drejtës për një vendim të arsyetuar, siç garantohet me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNj-së, si të tilla, i takojnë kategorisë së tretë (iii) “pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara” prandaj edhe në këtë pjesë kërkesa është qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese.

ii. Sa i përket pretendimeve tjera

85. Në vlerësimin e këtyre pretendimeve tjera, Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës, përveç pretendimeve për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë pretendon dhe në shkelje të nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe të nenit 13 të KEDNj-së. Megjithatë, parashtuesi i kërkesës shkeljen e këtyre dy neneve e ndërlidhë me nenin 31 të Kushtetutës, për të cilën Gjykata sa më lart konstatoi, se kërkesa në këtë pjesë duhet deklaruar qartazi e pabazuar në baza kushtetuese. Gjykata përsërit se vetëm përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së ose ndërlidhja e tyre me një nen tjetër të Kushtetutës nuk nënkupton me automatizëm edhe shkelje të neneve tjera të Kushtetutës dhe KEDNj-së, nëse më tej nuk argumentohet dhe shtjellohet se si dhe përse ka ardhur deri te shkelja e tyre. Gjykata vazhdimisht ka theksuar se vetëm referimi dhe përmendja e neneve të Kushtetutës dhe të KEDNj-së nuk është e mjaftueshme për të ndërtuar një pretendim të argumentuar për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNj, parashtuesit e kërkesës duhet të sigurojnë pretendime të arsyetuara dhe argumente bindëse (shih, në këtë kontekst, rastet e Gjykatës: KI175/20, me parashtues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 22 prillit 2021, paragrafi 81; KI166/20 cituar më lart, paragrafi 52; KIo4/21, me parashtuese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri, i 11 majit 2021, paragrafët 38-39).
86. Për këto arsye, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës dhe nenit 13 të KEDNj-së, i përkasin kategorisë së tretë (iii), nënkategorisë (a), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, në baza kushtetuese edhe këto pretendime duhet të shpallen qartazi të pabazuara.

Përfundim

87. Si përmbledhje, Gjykata, duke i marrë parasysh të gjitha shtjellimet dhe konstatimet e mësipërme, konkludon se: i) pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, përkritazi me “vërtetimin e fakteve dhe të zbatimit të ligjit”, i përkasin kategorisë së parë (I), pretendime të “*shkallës së katërt*” të cilat reflektojnë pretendime në nivel ligjshmërie dhe jo kushtetutshmërie, ii) pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6.1 të KEDNj-së, përkritazi me “të drejtën për vendim të arsyetuar”, i përkasin kategorisë së tretë (III), nënkategorisë (b), të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj, si të tilla, të njëjtat i shpallë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, dhe iii) pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje të nenit 32 dhe 54 të Kushtetutës, si dhe nenit 13 të KEDNj-së, i përkasin po ashtu kategorisë së tretë (III), nënkategorisë (a) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, andaj të njëjtat, gjithashtu i shpallë si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese.
88. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësinë e saj, duhet të shpallet e papranueshme, si qartazi e pabazuar, në baza kushtetuese, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullat 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, në seancën e saj të mbajtur, më 8 qershor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Bajram Ljati



Gresa Caka-Nimani